



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH II.nr.972/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbarimore të kreditorit D.O.O. “MIVEX”, me NRB:17126329, me seli në Çaçak, Serbi, përfaqësuar nga Ivan Cvurovic, të cilin sipas autorizimit Visar Ostrozubi, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Railtrans”, L.L.C., me numër të regjistrimit të biznesit: 70487616, përfaqësuar nga drejtori gjeneral B.Ç., adresa Zona Industriale ish fabrika e Amortizerave K.2., nr.52, Fushë Kosovë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Për Cështje Ekonomike, KPPP.nr.1327/22, të datës 26.05.2023, me datë 09.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit D.O.O. “MIVEX”, me NRB:17126329, me seli në Çaçak, Serbi, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Për Cështje Ekonomike, KPPP.nr.1327/22, të datës 26.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Për Cështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1327/22, të datës 26.05.2023, në pikën I të dispozitivit ka vendosur si në vijim: PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Railtrans”, L.L.C, ANULOHET urdhri përmbarimor P.nr.498/19 i datës 06.05.2019, i Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Për Cështje Ekonomike, KPPP.nr.1327/22, të datës 26.05.2023, apo lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet në tërësi ankesa e kreditorit dhe të vërtetohet vendimi i atakuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit D.O.O. “MIVEX”, ka caktuar urdhrin P.nr.498/2019 të datës 06.05.2019 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.564/90 e datës 28.08.2018, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Railtrans”, L.L.C., që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,830.00€, me kamatë prej 8 % nga dita e arritshmërisë për pagesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, dhe të barten në llogarinë bankare të përfaqësuesit të kreditorit avokatit Visar Ostrozubi, me nr. në TEB BANK, në të kundërtën realizimi i përmbartimit të bëhet përmes ndalimit e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbartuesit privat, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në përmbushjen e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke i propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përmbartimor me P.nr.498/19 i datës 06.05.2019 për lejimin e përmbartimit të propozuar, si i kundërligjshëm.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka deklaruar se propozimi i debitorit dhe arsyetimi janë në kundërshtim me vetveten dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimi i parashtruar të refuzohet si i pa bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata në shkallë të parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim: dokumenti – Fatura nr. 564/90 e datës 28.08.2018, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin dhe as vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori. Gjykata në shkallë të parë vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit në atë se në shkresat e lëndës janë dorëzuar komunikimet elektronike në mes të palëve, ku është përshkruar kryerja e shërbimit, mirëpo vlerësoi se një komunikim i tillë nuk mund të konsiderohet i rregullt për arsye se nuk kemi një konfirmim nga ana e debitorit lidhur me pranimin apo mos pranimin e Faturës nr.564/90 të datës 28.08.2018, përmes së cilës është iniciuar propozimi për përmbarim.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim P.nr.498/19 i datës 06.05.2019, duke vlerësuar se fatura nuk i plotëson kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm. Sipas dispozitës së nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të*

dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturës, Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura, në rastin konkret fatura në bazë të cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas ligjit pasi që pala kreditore është dashur së pari ta lëshoj faturën në mënyrë të rregullt duke shënuar në të njëjtat, të dhënat lidhur me debitorin, kohën e përbushjes së detyrimit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbarimore.

Dhoma e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar pasi që urdhri për përmbarim është lëshuar në kundërshtim me nenin 29 par 1 pika 1.3 dhe par 3 të LPP-së.

Kreditori mund të inicoj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk.nr.972/23, me datë 09.10.2023

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti